

**Tiranë, më 2.4.2025**

## **Njoftim për shtyp**

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar (SPAK), z. Altin Dumani, në ushtrim të kompetencës së Komisionerit Publik, autorizoi z. Klodjan Braho, me funksion Prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, (njëkohësisht Drejtuesi i Seksionit Kundër Korrupsionit), për ta përfaqësuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, gjatë shqyrtimit gjyqësor të ankimit kundër vendimit nr. 762, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Afrim Shehu, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë.

Gjatë verifikimit të prezencës, kryesuesja e trupit gjykues bëri me dije se palët ishin njohur me parashtrimet dhe i ftoi t'i paraqisnin ato në seancë.

Drejtuesi i Seksionit Kundër Korrupsionit në Prokurorinë e Posaçme z. Klodjan Braho, parashtrori gjetjet vetëm për shkaqet e ankimit, që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke njoftuar heqjen dorë nga shkaqet e ankimit, për kriterin e aftësive profesionale. Në përmbyllje të parashtrimeve të tij, z. Braho çmoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë dhe i kërkoi Kolegjit që në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të ndryshojë vendimin nr. 762, datë 8.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe të shkarkojë nga detyra subjektin e rivlerësimit, z. Afrim Shehu.

Subjekti i rivlerësimit, fillimisht përmes përfaqësueses ligjore, kundërshtoi gjetjet në kriterin e pasurisë dhe shpjegoi edhe rrethanat mbi shkaqet e ngritura në ankim mbi aftësitë profesionale. Ai kërkoi depozitimin e dhjetëra akteve, që sipas tij provojnë të kundërtën e shkaqeve dhe kërkimit të ankimit.

Palët u pyetën edhe rreth denoncimeve nga publiku. Për një prej tyre, ata u shprehën se është ankesë e përsëritur më parë në Komision. Ndërsa për dy denoncimet e depozituara para ankimit, Drejtuesi i Seksionit Kundër Korrupsionit në Prokurorinë e Posaçme, u shpreh se ato nuk përmbanin shkaqe për hetim të mëtejshëm.

Trupi gjykues vendosi të mos hetojë mbi denoncimet e mësipërme, të çelë hetimin gjyqësor të çështjes dhe të administrojë në cilësinë e provës aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit. Në kushtet kur palët nuk referuan kërkesa të tjera procedurale dhe kërkuan kohë për përgatitjen e bisedimeve përfundimtare, trupi gjykues vendosi të shtyjë seancën më datë 22.4.2025, ora 11:30.

Ankimi dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të SPAK-ut, në rubrikën “Procesi i rivlerësimit”:  
<https://spak.gov.al/>

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimet të Organizuar, referuar nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ushtron kompetencat e Komisionerëve Publikë, që prej datës 1.1.2025.